

VENDIM
Nr. 727, datë 28.8.2013

**PËR NDRYSHIMIN E KATEGORISË SË TOKËS BUJQËSORE ME NUMËR PASURIE 198/15,
ZONA KADASTRALE NR. 1288, MAT, ME SIPËRFAQE 1000 M², NË TOKË URBANE
(TRUALL) PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “PRELLË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3 të nenit 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore me numër pasurie 198/15, zona kadastrale nr. 1288, volumi 3, faqja 103, me sipërfaqe 1000 m², regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Mat, në tokë urbane (truall) për ndërtimin e hidrocentralit “Prellë”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha